



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 5 (827757)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 11 Shkurt 2022

Takimi/ SHSHP i FA-së, Begaj - kolonel Morris



Gjeneralmajor Begaj: Bashkëpunim i shkëlqyer mes dy ushtrive mike dhe aleate në NATO

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor, Prof. Asoc. Barjam Begaj, priti në një takim kortezie komandantin e Ekipit të Këshilltarëve dhe Trajnuesve Britanikë (British Military Advisory Training Team, BMATT), kolonel Paul Morris. Në bisedën me kolonel Morris, gjeneralmajor Be-

gaj e vuri theksin tek bashkëpunimi i shkëlqyer që ekziston mes dy ushtrive mike dhe aleate në NATO. Ai falënderoi në veçanti kolonel Morris për mbështetjen që ushtria britanike po i jep personelit të Forcave të Armatosura shqiptare, nëpërmjet ofrimit të kurseve dhe trajnimeve si në...

» faqe 2

Policia Ushtarake

Kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i ri i PU-së. Peleshi: Të shtojmë përgjegjësitë si aleatë të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Jam i gëzuar që kemi përzgjedhur si komandant të Batalionit të Policisë Ushtarake (PU) një kolonel, i cili është dalluar për përgjegjshmërinë, përkushtimin dhe integritetin » faqe 3



Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Falënderues për bashkëpunimin në fushat e trajnimit të pilotëve



» faqe 5

"Junior Command and Leadership Course"

Gjeneral brigade Kingji: Kursi i lidërsipit, gur themeli në ecurinë e karrierës së oficerëve të rinj

Në ambientet e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit "Junior Command and Leadership Course". Në këtë aktivitet morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, atashu ushtarak britanik nënkolonel Christopher Maycock, komandanti i Ekipit të Këshilltarëve dhe Trajnuesve Britanikë...



» faqe 4

Komanda Mbështetëse

Xhenierët ndihmojnë në pastrimin nga mbetjet plastike dhe eliminimin e problematikave në grykëderdhjen e lumit Shkumbin

P prej disa ditësh, forcat dhe mjetet e Batalionit të Xhenios kanë shkuar në mbështetje të bashkisë Rrogozhinë për vënien nën kontroll të lumit Shkumbin, i cili ka shkaktuar dëme në infrastrukturë, bujqësi dhe mjedis. Puna e Komandës Mbështetëse me efektivët e mjetet xheniere ka konsistuar në pastrimin dhe heqjen...

» faqe 2



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s

Stoltenberg diskuton zhvillimet e ushtrisë ruse me Presidentin e Polonisë

» faqe 8

6 SHKURT 1981 - TRAGJEDIA E FEKENIT

"Lavdi Dëshmorëve të Atdheut, nderim dhe mirënjohje për veprën tuaj"

» faqe 6

EUROPEAN SECURITIES AND MARKETS AUTHORITY

Duke ecur në rrugën e duhur në një botë digjitale në zhvillim

» faqe 10-11

Takimi/ SHSHP i FA-së, Begaj - kolonel Morris

Gjeneralmajor Begaj: Bashkëpunim i shkëlqyer mes dy ushtrive mike dhe aleate në NATO

Falënderues për mbështetjen që ushtria britanike i jep personelit të Forcave të Armatosura shqiptare

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor, Prof. Asoc. Barjam Begaj, priti në një takim kortezie komandantin e Ekipit të Këshilltarëve dhe Trajnuesve Britanikë (British Military Advisory Training Team, BMATT), kolonel Paul Morris.

Në bisedën me kolonel Morris, gjeneralmajor Begaj e vuri theksin tek bashkëpunimi i shkëlqyer që ekziston mes dy ushtrive mike dhe aleate në NATO. Ai falënderoi në veçanti kolonel Morris për mbështetjen që ushtria britanike po i jep personelit të Forcave të Armatosura shqiptare, nëpërmjet ofrimit të kurseve dhe trajnimeve si në Britaninë e Madhe, po ashtu edhe në Shqipëri. Treguesi më i fundit i kësaj mbështetje sipas gjeneral Begajt është edhe kursi "Junior Command and Leadership Course", i organizuar nga BMATT në vendin tonë, me pjesëmarrjen e oficerëve të rinj të Forcave të Armatosura shqiptare.

Kolonel Morris, duke falënderuar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Begaj për pritjen e rezervuar, vlerësoi me nota të larta dhe pozitive bashkëpunimin me Forcat e Armatosura shqiptare, duke shprehur bindjen se ky bashkëpunim do të forcohet edhe më tepër në të ardhmen. Ekipi i BMATT është një grup i kombinuar britanik dhe çek, me vendndodhje në Vyškov, në Çeki, i themeluar në vitin 2000.



Koncepti i kësaj strukture të përbashkët është ofrimi i kurseve dhe trajnimeve ushtarake, këshillimi për vendet partnere, me qëllim zhvillimin profesional dhe aftësive të forcave të armatosura respektive

për të marrë pjesë në operacionet shumëkombëshe të mbështetjes së paqes. Personeli i BMATT janë të gjithë instruktorë me cilësi të lartë dhe me një përvojë të pasur operacionale.

Kolonel Morris, duke falënderuar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Begaj për pritjen e rezervuar, vlerësoi me nota të larta dhe pozitive bashkëpunimin me Forcat e Armatosura shqiptare, duke shprehur bindjen se ky bashkëpunim do të forcohet edhe më tepër në të ardhmen.



KOMANDA MBËSHETËSE

Xhenierët ndihmojnë në pastrimin nga mbetjet plastike dhe eliminimin e problematikave në grykëderdhjen e lumit Shkumbin



Prej disa ditësh, forcat dhe mjetet e Batalionit të Xhenios kanë shkuar në mbështetje të bashkisë Rrogozhinë për vënien nën kontroll të lumit Shkumbin, i cili ka shkaktuar dëme në infrastrukturë, bujqësi dhe mjedis. Puna e Komandës Mbështetëse me efektivët e mjetet xheniere ka konsistuar në pastrimin dhe heqjen e sasive të konsiderueshme mbetjesh plastike e drusore në grykëderdhjen e lumit Shkumbin në bashkinë Rrogozhinë si dhe mbushje të një segmenti rrugor me çakull, në një pjesë të rrugës që çon në zonën turistike të Vilboshtovës. Ky operacion, i cili ka ndihmuar në pastrimin e grykëderdhjes së lumit Shkumbin, është vlerësuar në mënyrë të veçantë edhe nga zëvendës prefekti i Tiranës dhe administratorja e Njësisë Administrative Gosë, Kavajë dhe i shërben jo vetëm eliminimit të problematikave të përmytjeve, pastrimit të ujit të detit por dhe turizmit në vendin tonë.



Kolonel Shkëlqim Çela ka marrë zyrtarisht detyrën e Komandantit të Policisë Ushtarake. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi theksoi rëndësinë që ka kjo strukturë si pjesë e Forcave të Armatosura.

“Forcat e Armatosura të Republikës Shqipërisë në opinionin publik gëzojnë një reputacion pozitiv të lartë. Në shumë sondazhe dalin të parët në renditje, pra, institucioni më i besueshëm për publikun. FA-të janë një garanci për sigurinë kombëtare e për këtë arsye për shkak të funksionit të tyre dhe rëndësisë së madhe që kanë, integriteti brenda të gjitha strukturave të FA-së është një element kyç. Ndaj sot jam i gëzuar që ne kemi përzgjedhur si komandant të Batalionit të Policisë Ushtarake (PU) një kolonel, i cili është dalluar mes shokëve, kolegëve për përgjegjshmëri në kryerjen e detyrës, për përkushtimin dhe integritetin me të cilin ka kryer të gjitha detyrat e mëparshme dhe kjo për ne dhe për mua personalisht, përbën një garanci që në krye të komandës së PU-së, kolonel Shkëlqim Çela si komandant i saj do të bëjë më të mirën, do na zbardhë faqen natyrisht edhe do ta ngrejë punën e bërë deri tani në një nivel më të lartë.”, - u shpreh ministri Peleshi. Ministri i Mbrojtjes falënderoi edhe kolonel Jeminin, i cili për pothuajse 6 muaj drejtoi këtë batalion në detyrën e zëvendëskomandantit. Z. Peleshi theksoi faktin se FA ka marrë detyra të rëndësishme në misionet jashtë vendit në kuadër të NATO-s, si në Afganistan, Egje e së fundmi edhe në kampin e refugjatëve të Bechtel Enka. Ministri Peleshi tha se po i kushtohet rëndësi shumë e madhe rekrutimin në sasi dhe cilësi të të rinjve që duan të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura.

“Aktiviteti i FA-së është shumë herë më i madh, përgjegjësitë tona janë shumë herë më të mëdha sidomos në një situatë gjeopolitike që ka kompleksitetin, dinamikën e vet edhe po ndryshon në drejtime shpesh herë jo pozitive në rajone që nuk janë shumë larg nga ne dhe që na impaktojnë në mënyrë direkte apo indirekte edhe rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor. Duke u vendosur edhe në një kontekst më të gjerë puna e gjithsecilit prej jush, natyrisht duke respektuar të gjithë zinxhirin e komandimit, pra duke filluar nga komandantët e deri tek ushtari i parë është shumë e rëndësishme. Duhet ta kuptojmë përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e shtuar që duhet të ketë gjithsecili prej nesh në FA, duke mbajtur parasysh që jemi pjesë e aleancës së madhe ushtarake të NATO-s. Na duhet shumë punë për ta mbajtur me nder dhe për ta merituar këtë pozicion krahas më të mirëve dhe më të fortëve në kuptimin politik dhe ushtarak, na duhet të investojmë për të rritur standardet në të gjitha forcat tona, na duhet të rrisim kapacitetet, të plotësojmë objektivat.”, - u shpreh gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi.

Kolonel Shkëlqim Çela ka mbajtur edhe detyra të tjera shumë të rëndësishme në Forcat e Armatosura si ajo e shefit të Shtabit në Komandën Mbështetëse.



Policia Ushtarake

Kolonel Shkëlqim Çela komandanti i ri i PU-së. Peleshi: Të shtojmë përgjegjësitë si aleatë të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Jam i gëzuar që kemi përzgjedhur si komandant të Batalionit të Policisë Ushtarake (PU) një kolonel, i cili është dalluar për përgjegjshmërinë, përkushtimin dhe integritetin me të cilin ka kryer të gjitha detyrat e ngarkuara dhe kjo për ne, për mua personalisht, përbën një garanci që në krye të komandës së PU-së, kolonel Shkëlqim Çela si komandant i saj do të bëjë më të mirën



Batalioni i Forcave Speciale i Regjimentit të Operacioneve Speciale në Forcën Tokësore zhvilloi një stërvitje në kushte ekstreme të motit dhe në praninë e dëborës në Voskopoje të Korçës. Kjo stërvitje u mbajt në kuadër të planit vjetor stërvitor të Forcës Tokësore, e cila po teston kapacitetet operacionale në stërvitjen dimërore “Selita 02”. Pjesë e stërvitjes, veç operimit në kushte të vështira të motit dhe terrenit malor, është testimi i kapaciteteve të dislokimit dhe realizimi i goditjes së objektit si dhe ridislokim në garnizon.

Forcat Speciale, stërvitje 72-orëshe në kushte ekstreme moti në Voskopoje



Në ambientet e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit “Junior Command and Leadership Course”.

Në këtë aktivitet morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, atashu ushtarak britanik nënkolonel Christopher Maycock, komandanti i Ekipit të Këshilltarëve dhe Trajnuesve Britanikë (British Military Advisory Training Team, BMATT) kolonel Paul Morris etj.

Gjeneral brigade Kingji shprehu mirënjohjen e tij të veçantë për palën britanike dhe zyrën e atashut ushtarak britanik në vendin tonë, në lidhje me ofrimin e kurseve të kësaj natyre. Ai vlerësoi kursin e lidërshipt, si gurin e themelit për ecurinë në karrierë të oficerëve të rinj. Me tej, ai adresoi falënderimet dhe mirënjohjen e tij edhe për instruktorët britanikë, për dedikimin e tyre në mësimdhënie gjatë gjithë periudhës së trajnimit.

Ceremoninë e përshëndeti edhe komandanti i BMATT kolonel Paul Morris, i cili përgëzoi të gjithë kursantët për përfundimin me sukses të kursit. Ai shprehu gjithashtu besimin se bashkëpunimi i shkëlqyer me palën shqiptare, do të rritet edhe më tej nëpërmjet trajnimeve dhe angazhimeve dypalëshe.

“Junior Command and Leadership Course” u zhvillua në periudhën 10 janar- 2 shkurt 2022, në bashkëpunim me palën britanike dhe nën drejtimin e instruktorëve nga Forcat e Armatosura Mbretërore të Britanisë së Madhe. Audienca e përzgjedhur për ndjekjen e këtij programi përbëhej nga 30 oficerë të gradave nëntoger dhe toger, efektivë të reparteve të ndryshme të Forcave të Armatosura, ku në përfundim të kursit u certifikuan 26 kursantë.

Gjatë periudhës së këtij trajnimit nga ana e instruktorëve britanikë u synua rritja e aftësive taktike dhe tekniko-profesionale të ushtarakëve tanë. Programi i “Junior Command and Leadership Course” përmbante tema të larmishme kryesisht të fushës së taktikës së këmbësorisë dhe lidërshipt ushtarak. Qëllimi i temave të përzgjedhura ishte zgjerimi dhe konsolidimi i background-it profesional të oficerëve të rinj si liderë të së ardhmes.

Më herët, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim komandantin e BMATT kolonel Paul Morris dhe atashun ushtarak britanik në vendin tonë, nënkolonel Christopher Maycock.

Gjatë bisedës, nga të dyja palët u vlerësua niveli i lartë i bashkëpunimit që ekziston mes Forcave të Armatosura respektive dhe u ra dakord, që ky nivel bashkëpunimi të forcohet edhe më tej në të ardhmen, përmes trajnimeve të përbashkëta.



“Junior Command and Leadership Course”

Gjeneral brigade Kingji: Kursi i lidërshipt, gur themeli në ecurinë e karrierës së oficerëve të rinj

Ceremonia e përfundimit të kursit në Forcën Tokësore. Mirënjohje për instruktorët britanikë, për dedikimin e tyre në mësimdhënie gjatë gjithë periudhës së trajnimit



Shtatë nënoficerë të rinj i janë bashkuar trupës së nënoficerëve të Batalionit II të Këmbësorisë i Forcës Tokësore (b2kFT).

Pas përfundimit të Kursit Bazë në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN), shtatë ish-ushtarët IV të b2kFT, morën sot gradën e nëntetarit. I pranishëm në ceremoni ishte komandanti i b2kFT nënkolonel Agim Kucana, i cili duke përgëzuar nënoficerët e rinj për këtë arritje në karrierë, shprehu besimin se ata do të jenë kontribues me vlera për realizimin me sukses të çdo detyre.

Të konsideruar si shtylla kurriore e ushtrisë, shtimi i numrit të nënoficerëve në Batalionin II të Këmbësorisë, si një nga repartet më të rëndësishme të Forcës Tokësore, pritet të ndikojë ndjeshëm në rritjen e përgatitjes cilësore profesionale të trupës së ushtarëve të këtij reparti.

Gradohen nënoficerët e rinj në Batalionin II të Këmbësorisë



Komandanti i Forcës Ajrore priti në takim atasheun e Republikës së Turqisë, kolonel Kablay

Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Falënderues për bashkëpunimin në fushat e trajnimit të pilotëve, teknikëve, kontrollorëve të trafikut ajror

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në një takim atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonel Muhammet Kelami Kablay, i cili shoqërohej nga asistenti i tij kapiten Ali Semih Atalay. Gjeneral Pulaj falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas dhe vlerësoi bashkëpunimin dhe kontributin e vazhdueshëm që Republika e Turqisë dhe Forcat e Armatosura turke kanë dhënë për Forcën Ajrore si dhe shprehu mundësitë e vijimit të këtij bashkëpunimi në fushat e trajnimit të pilotëve, teknikëve, kontrollorëve të trafikut ajror, por edhe në fushën e mirëmbajtjes së mjeteve fluturuese të Forcës Ajrore. Më pas, Kolonel Kablay, falënderoi komandantin e Forcës Ajrore për pritjen dhe shprehu gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit në fushat që të dy palët e shohin me interes të përbashkët duke sugjeruar përfshirjen e këtyre propozimeve në planet e bashkëpunimit ushtarak me qëllim konkretizimin e tyre në të ardhmen.



Certifikohen 40 kursantë në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve

Në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursit 49-të të Avancuar, në të cilën morën pjesë Komandanti i QAPN-së, personel nga Dega Arsimit, Administratës, si dhe stafi instruktorë dhe mësimdhënës.

Në këtë ceremoni përshëndetën Komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve, instruktori përgjegjës i kursit Avancuar dhe kursanti që doli me rezultate të larta.

Komandanti i QAPN-së, Kolonel Arben Toska, në mbyllje të fjalës së tij të rastit në këtë ceremoni përmendi në fund një citim nga një ushtarak amerikan i cili thotë se: “Në fund të ditës duhet që kur një nënoficer del përpara ushtarëve të vet, ata duhet të shohin tek ai shëmbëlltyrën e vetvetes, shihni sytë e tyre dhe do të dalloni sa mirë jeni duke drejtuar.”



Trajnim i personelit të Forcës Ajrore në Qendrën e Bashkuar të Operacioneve Ajrore në Torrejon, Spanjë

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak midis Qendrës së Kontroll-Raportimit (QKR) të Forcës Ajrore shqiptare dhe Qendrës së Bashkuar të Operacioneve Ajrore (CAOC, Torrejon) në Spanjë u zhvillua prej disa ditësh trajnimi i efektivit të QKR mbi procedurat dhe rregullat e zhvillimit të Policimit Ajror. Qëllimi i trajnimit ishte jo vetëm familjarizimi i personelit ushtarak shqiptar me procedurat dhe rregullat e zhvillimit të Policimit Ajror, por edhe unifikimi dhe konsolidimi i njohurive të cilat do të standardizohen gjatë përditshmërisë së punës. Ekipi i ushtarakëve të Forcës Ajrore u prit nga komandanti i CAOC Torrejon, gjeneralletjtënant Fernando De La Cruz, i cili përshëndeti ekipin për pjesëmarrjen dhe i falënderoi për angazhimin e tyre maksimal.

6 SHKURT 1981 - TRAGJEDIA E FEKENIT

“Lavdi Dëshmorëve të Atdheut,
nderim dhe mirënjohje për veprën tuaj”

Një histori e trishtë, nga ato që të dhemb zemra tek e dëgjon. Kjo tokë është larë me gjak nga heronjtë e saj, të cilët na bëjnë krenarë kudo ku jemi. Ngjarja e rëndë e 6 shkurtit të vitit 1981, ku humbën jetën 11 pedagogë e studentë ushtarakë, gjatë një stërvitjeje dimërore në malin me borë mbi Dajt. Në historikun e saj të pas Luftës së Dytë Botërore, ushtria shqiptare e ka memorizuar këtë si ndodhinë më të rëndë, me numrin më të madh të viktimave e të lënduarve.

Kanë kaluar plot 41 vite qysh atëherë, kur në opinionion publik është folur gjithmonë me rezerva për katastrofën që ndodhi gjatë atij demonstrimi, në kushte shumë të vështira moti e terreni. Madje, në periudhën kur ndodhi, autoritetet zyrtare ndaluan në mënyrë të prerë transmetimin e lajmit në mediat e kohës. Për vite të tëra, ngjarja u vesh me një lloj misteri dhe në asnjë rast, gjatë periudhës së komunizmit, për të nuk u zhvillua ndonjë ceremoni zyrtare, përjashtuar takimin e përvitshëm të familjarëve të viktimave në vendin e ngjarjes dhe përshpirtjen e bashkëkohësve të tyre në mjediset e Akademisë Ushtarake. Vetëm pas viteve ‘90, të rënë e orteku të Fekenit u shpallën “Dëshmorë të Atdheut” dhe të mbijetuarit u dekoruan me medalje të ndryshme. “Orteku i parë rrëmbeu më shumë se gjysmën e kolonës”, -do të tregonte njëri nga ish-pedagogët e përgatitjes fizike, që atë ditë udhëhiqte marshimin e dy nënrepartëve. Ka qenë pikërisht në qendër të goditjes nga orteku dhe ka parë me sytë e tij tërë atë “gjëmë”, -siç thotë ai “që rrëmbeu, sa hap e mbyll sytë, gati tërë kolonën e gjatë të studentëve që i ngjiteshin Micekut”. Ishte mëngjesi i 6 shkurtit të vitit 1981. Ishte një ditë e ftohtë dhe me erë të rrëmbyeshme. Me 12 toga, që kishin në përbërjen e tyre 204 studentë, atë ditë do të realizohej ngjitja malore me elementë të alpinizmit, në një terren të thyer dhe me trashësi të madhe bore. Nisja ishte e zakonshme, si në të gjitha ditët e tjera. Kolonën e marshimit e udhëhiqte, pedagogu Mark Mici. Për çdo rast nevojë, ishin 15 pushkatarë të vendosur 5 në krye të kolonës, 5 në mes dhe 5 të tjerë në fund të saj. Ata garantonin jetën e shokëve nga çdo e papritur gjatë marshimit. Kështu veprohej gjithnjë në demonstrime që bënim jashtë fushimit e sidomos gjatë stërvitjeve në lartësi dhe në pyje, ku edhe gjatë verës nuk ka jetë. Ju kishte ndodhur jo rrallë përballja me kafshë të egërsuara, madje edhe me arinj të uritur. Gjithsesi, vështirësive të kësaj natyre ua kishin marrë dorën dhe u paraprinin me masa sigurie të veçanta...Kur kreu i kolonës arriti në majën “Tre pemët e vetmuara”, siç e kishin koduar në hartat topografike, nën këmbët e tyre rrëshqiti me një shpejtësi të jashtëzakonshme e tërë faqja e malit, e mbështjellë me një trashësi të madhe dëbore. Ishte një goditje e befte dhe e fuqishme, që ushroi me një gjëmim shurdhues dhe rrëmbeu me vete sa hap e mbyll sytë gati gjysmën e kolonës. Për pak sekonda humbën nën trashësinë e dëborës. Sakaq, ai mal i madh dëbore rrëshqiste e rrëshqiste me shpejtësinë e rrufesë shpatit të thepisur. Panik dhe ulërime, thirrje dhe krisma vijuan për pak çaste. Ata që mundën të dalin nga masivet e

bardha të borës bërtisnin e kërkonin ndihmë, për të shpëtuar shokët e mbetur në rrënojat e ortekut, që aty për aty kishte gëlltitur gjysmën e efektivit...”. Njeriu që e ka parë nga afër goditjen e parë, kujton ndërkaq edhe çastet kur përballej vetë me vdekjen: “Më rrëmbeu vala e parë dhe nuk dija ku më çonte nëpër rrokullimë. U përplasa diku, mesa dukej në trunqun e një peme dhe më mbuloi sërish një masiv i madh bore. Isha mpirë i tëri dhe kur bëra të lëviz paksa, majat e gishtave më prekën në fytyrën e njërit prej shokëve të tjerë, që rënkonte me dhimbje mbi trupin tim. Mblodha për një çast veten dhe u përpoqa të dal mbi masivin e borës. Këtë provë kishte filluar të bënte edhe studenti që kishte rënë mbi mua. Dhe ashtu, të goditur e të gjakosur mundëm të çohemi në këmbë. Mblodha për një çast veten dhe hodha vështirimin përçarë, kur ç’ të shikoja, trupa të gjymtuar, pajisje e orendi të shpërndara poshtë e lart dhe shokë që bërtisnin e bërtisnin. Kishte ndodhur hataja e vërtetë, po aty për aty askush nuk mundte të bënte një bilanc të plotë. Kush kishte humbur, kush ishte gjymtuar, sa kishin vdekur, sa të tjerë prisnin me shpresë nën rrënojat e bardha të ortekut. Ndërkaq, në komandë, në qendër të fushimit ishte dhënë kushtrimi dhe pritej nga momenti në moment të vinin shokët e tjerë, për të kërkuar të humburit dhe për të transportuar të gjymtuarit. Në krye të këtij reagimi u gjend menjëherë ushtaraku i shtabit të përgjithshëm, Bashkim Topçiu, që atë ditë kishte ardhur për të inspektuar demonstrimet stërvitore në kushtet e vështira të motit dhe terrenit. Pastaj, të gjithë që nga komanda e shkollës, repartet e tjera e deri te punonjësit civilë...”. Petrit Murzaku: “Orteku i dytë ishte më i fuqishëm dhe më. Tashmë, te vendi i ngjarjes ishte

grumbulluar gati tërë efektiv i shkollës, për të ndihmuar të dëmtuarit dhe për të kërkuar trupat e shokëve nën rrënojat e dëborës. Afërsisht, pas dy orësh nga orteku i parë, goditi furishëm dhe në mënyrë të papritur i dyti, që shkaktoi edhe më shumë viktime...”. Kështu e nis përmblodhtas rrëfimin e tij Petrit Murzaku, njeriu që është gjendur në vendin e ngjarjes fill pas dhënies së sinjalit të kushtrimit, pastaj i rikthehet me detaje “gjëmës”, siç thotë ai, që ka parë me sy... “Lajmin, për atë që kishte ndodhur me togat që bënin ngjitjen malore, e mora vesh në godinat e fushimit. Menjëherë komunikova me komandantin e shkollës, Rustem Peçin, i cili në tronditje e sipër bëri organizimin e parë për t’u ardhur në ndihmë të dëmtuarve nga orteku i borës. Për te vendi i ngjarjes u nis rrefeshëm toga e gatishmërisë, e drejtuar nga Vasil Nathanaili, bashkë me ne, një grup kuadrosh të shtabit të shkollës që ato çaste ishim të angazhuar me detyra të tjera. Vetëm në pak çaste u gjenda aty, ku kolona ishte kacafytur me përbindëshin e bardhë dhe u tronditëm nga pamjet rrëqethëse e zërat lemeritës të studentëve, që nga plagët e shumta dhe dhimbja për shokët e vdekur, ishin pushtuar nga një gjendje ankthi dhe përjetonin një dramë të jashtëzakonshme. Njeriu që kishte udhëhequr marshimin, pedagogu i talentuar dhe shumë energjik, Mark Mici, kishte pësuar goditje psikike dhe lëvizte kuturu mbi relievën e përgjakur, duke bërtitur me fjalë e thirrje të pakuptimta: “Ishin shokët...”, “Humbën shokët...”, “Na ra mali mbi krye...”. E mbërtheva për supesh për ta përmendur dhe urdhërova dy-tre nga ushtarët e togës së gatishmërisë për ta çuar në fushim. Po Marku edhe në ikje vazhonte të njëjtin ritual: “Ishin shokët... Humbën shokët...”. Pasi ndava grupet e stu-

dentëve dhe pedagogëve për të kontrolluar në hapësirën ku orteku ishte përplasur së fundi dhe kishte gëlltitur në thellësi të tij trupat e pesë studentëve që ende nuk ishin gjetur, fillova të gërmoj pranë trunqut të një lisi, ku dalloheshin gjurmë gjaku dhe një palë dorashka të zeza që kishin mbetur mbi sipërfaqe. Gati në gjysmë metri thellësi, duart më prekën trupin e studentit Besnik Shehu dhe fillova ta nxjerr me kujdes. E dallova që në vështirimin e parë, ndërsa i bëja frymëmarrje artificiale. Ai ishte njëri nga studentët e njohur në mjediset e pedagogëve, jo vetëm për rezultate të shkëlqyera në mësim, por edhe për emrin e mirë që kishte bërë në ekipin e futbollit të shkollës dhe në grupin polifonik të Ansambllit Artistik të Ushtrisë, ku kishte spikatur, sidomos me interpretimin e këngës “Birbilenjtë trembëdhjetë...”. Bëra ç’ ishte e mundur për ta risjellë në jetë, po zemra e tij me sa duke kishte pushuar së rrahuri. Pak më tej, gjeta trupin e copëtuar të studentit Aleko Gjoni. Vazhduan gati dy orë gërmimet në dëborë. Me grupin tonë ishte bashkuar ndërkohë edhe pjesa e komanduesve dhe pedagogëve të tjerë, që kishin ndërprerë stërvitjen në terren dhe kishin mbërritur aty me një frymë. Ndër ta, më kujtohet Dushan Shameti, Nikollaq Bero, Çlirim Pulaj, Luftar Guri, Myzafer Kambo, Abaz Cipi, Sali Gjokutaj e dhjetëra të tjerë, që për çaste të tëra, me lot në sy, kërkonin trupat e studentëve të fundosur nga orteku. Tre të parët do të kishin fatin e keq që, gjatë këtij operacioni për të shpëtuar shokët, do të mbeteshin edhe vetë, duke u bërë pishtarë të humanizmit dhe solidaritetit njerëzor...”. Deri këtu rrëfimi i njeriut që ka drejtuar katedrën e përgatitjes fizike, vjen i plotë e me po atë vlagë që është përjetuar para 41 vitesh. Për atë që ka ndodhur më

“DËSHMORË TË ATDHEUT”

- Dushan Shameti komandant batalioni;
- Çlirim Pulaj oficer shtabi;
- Nikollaq Bero pedagog;
- Besnik Shehu student;
- Ilir Gramatikoi student;
- Bujar Ago student;
- Aleko Gjoni student;
- Qemal Lika student;
- Bilbil Pashai student;
- Nexhip Çoba student;
- Pëllumb Rrapo student.

tej, Petrit Murzaku e ka të vështirë ta zbardhë e shtjellojë. Për të ka dëgjuar çfarë i kanë thënë të tjerët, pasi për vete, siç thotë, ka qenë nën dëborë. “Ndërkohë që po bënim një bilanc të asaj që kishte ndodhur, ia behu orteku i dytë”, -shton Petriti. “I befasishëm, tronditës dhe me një zhurmë të llahtarshme, na ra mbi krye sa hap e mbyll sytë. Më rrëmbeu masivi i borës dhe nuk dija ku më çonte me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Ndjeja që përplasesha hera-herës me gurë e pemë dhe vazhdoja të rrëshqitja pa u orientuar se çfarë po ndodhte. Për çaste të tëra kështu, derisa orteku mbi mua do të përplasej furishëm në honin e rrugës, ku fillonte një masiv i dendur pemësh. U përmenda për një moment dhe pashë që isha ende gjallë. Në zgavrën ku kisha mbetur, provova të zgjas një rënë dorë dhe të mundohem për t’u çuar, po sasia e borës mbi trup më zhyti më thellë. U përpoqa sërish të orientohej dhe vazhdoja të gërryë mbi masivin e bardhë që më zinte frymën dhe më rëndonte pa masë. Munda të nxjerr jashtë vetëm dy gishtat e një rënë dorë dhe kjo kishte mjaftuar që, të tjerët, të mbijetuar fatmirësisht nga kjo gjëmë e madhe, të më nxirrnin nga thonjtë e vdekjes me të cilën bashkëjetova për minuta të tëra nën dëborë. Ndërsa mora disi veten, pashë se më kishte mbetur brenda njëra nga çizmet. Duke kërkuar për të, shokët, fare rastësisht, gjetën nën trashësinë e dëborës trupin e një studenti që ishte në grahmat e fundit. E nxorën menjëherë dhe si e përmendën, e nisëm për në spital. E deshi fati që edhe ai të mbijetojë. Kur kuroheshim bashkë në Spitalin Ushtarak, më thoshte shpesh me shaka se jetën e kishte dhuratë nga çizmja ime...Orteku i dytë na mori kështu jetën e gjashtë shokëve, mes të cilëve tri pedagogë, dhe gjymtoi mbi gjashtëdhjetë të tjerë, dy prej të cilëve ishin Përparim Velu nga Saranda dhe Luan Muça nga Peshkopia, që mbetën për tërë jetën të paralizuar”.

Ju shkruat historinë me gjakun tuaj, latë pas zemra që vajtojnë si atë ditë të tmerrshme të lajmit të zi, por ndër breza do të kujtoheni me respekt dhe mirënjohje siç dinë të lenë gjurmë njerëzit në uniformën ushtarake.



Nostalgji ke moshën time

PUNOI: ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT
TË BOTIMEVE

Shoqëria njerëzore ka ndryshuar shumë, po ashtu kanë ndryshuar normat, rregullat dhe mënyra e jetesës, zhvillimet teknologjike kanë shkëputur njerëzimin nga realiteti për ta bërë pjesë të pandashme të virtualitetit. Kjo ka ndikuar edhe tek brezat e fëmijëve pas viteve 90’. Por a po jetojnë fëmijërinë në të gjitha dimensionet e saj? A ndihen të lumtur fëmijët tanë nën trysninë e të panjohurës?

Fëmijëria e prindërve

Ishte një jetë shumë e thjeshtë, mbase kjo ishte dhe e bukura e jetës tonë. Fëmijëria është momenti më i artë i jetës, për faktin që në fëmijërinë tonë ne jemi rritur realisht si fëmijë, pra të vritesh, të luash, të rrëzohesh duke kapur topin, lojëra fantastike që mund të kenë qenë shumë të thjeshta por kanë qenë kaq shumë reale sa që edhe pse vriteshim përsëri ishim shumë të lumtur sepse kishim harxhuar energji dhe adrenalinë për gjërat që donim.

Fëmijëria është një nga periudhat më të bukura të jetës për çdo njeri. Të gjithë e kujtojmë me nostalgji këtë periudhë, sidomos kur bëhen krahasimet e brezave dhe lojërave të tyre mes lojërave të thjeshta dhe çelësit në qafë që mbanin shumë prej tyre.

Kur ka qenë hera e fundit që keni dëgjuar një histori që me të vërtetë ka mbetur në kokën tuaj? Ndoshta diçka që keni lexuar, e keni parë apo diçka që ka mbetur e trashëguar ndër breza ... Ndërsa disa prej nesh mësojmë më mirë përmes numrave dhe fakteve, shumica prej nesh ndërliidhemi përmes përvojave dhe emocioneve. Secili prej nesh mund të sjellë ndër mend kujtime të ëmbla që lidhen me tregimet e rrëfyera nga gjyshërit tanë; ndonjëherë rreth ndonjë tryeze gjatë darkës apo pranë vatrës së zjarrit gjatë ndonjë nate të ftohtë dimri. Duke u treguar nga brezi në brez, për dekada të tëra, dhe ndonjëherë edhe për shekuj me radhë, secili rrëfim thuhet në aq shumë mënyra, duke e mbajtur thelbin e tregimit por çdo herë duke i shtuar nga një shije të ndryshme. Tregimi ka qenë një pjesë e rëndësishme e njerëzimit që nga kohët tona më të hershme, kur njerëzit vazhdimisht tregonin historitë e tyre, duke ndarë kështu me brezat e rinj porositë mbi vlerat, identitetin dhe përkatësinë. Moshë luan një rol thelbësor në mënyrën se si ne e perceptojmë trashëgiminë. Është vërejtur se fëmijët ndërliidhin trashëgiminë me diçka “të vjetër” apo historike, derisa të rriturit mund ta ndërliidhin trashëgiminë me identitetin. Më të moshuarit mund të ndërliidhin trashëgiminë me “të kaluarën e artë”



dhe vlerat e “humbura”. Por rëndësia e trashëgimisë vlerësohet në të gjithë brezat. Transmetimi i vlerave të trashëgimisë tek brezat e rinj ka qenë një proces me rëndësi të veçantë për të moshuarit në mënyrë që të sigurohet mbijetesë kulturore. Edhe pse epoka digjitale dhe rrjetet sociale gjithnjë e më shumë luajnë një rol dominues në ndarjen e tregimeve e ndjenjave, përvoja e drejtpërdrejtë njerëzore sërish mbetet shumë efikase, veçanërisht për fëmijët.

Një brez nostalgjik për realitetin e bukur në kohë të vështirë

- Brezi që shkonte në shkollë dhe kthehej nga shkolla në këmbë.
- Një brez që i bënte vetë detyrat për të dalë në rrugë sa më shpejt për të luajtur.
- Një brez në të cilin djemtë luanin futboll me porta te sajuara me gurë ndërsa vajzat me kërcim litari apo kukullash të sajuara nga duart e tyre.
- Një brez që e kalonte gjithë kohën e lirë në rrugë.
- Një brez që luante kukafshehthi derisa behej natë.
- Një brez që bënte deri edhe zinxhirë letre me duart e veta për të zbkuruar festat.

- Një brez që mblidhte fotografi, bënte fjalorë me dorë dhe mbante fletore kujtimesh në shkollë.
- Ne jemi brezi që e pa babin të rregullonte televizorin madje edhe brezi që e ndihmonte të rregullonte antenën.
- Një brez që kishte prindër, jo të moshuar.
- Një brez që qeshte me zë të ulët para se të flinte, që prindërit tanë të mos e dinin se ne jemi ende zgjuar.
- Një brez që pinin nga e njëjta

- shishe dhe jepnin një kafshatë nga ushqimet e tyre të shkollës.
- Një brez që shkonte tek miku e shoku edhe pa paralajmërim edhe pse bëheshin deri në 10 në një grup.
- Një brez që takohej çdo ditë në një vend të caktuar pa celularë.
- Një brez autoriteti i të cilit ishin prindërit, si të tyret ashtu edhe te miqve.
- Një brez që përshëndeste të gjithë kalimthi kur hipte në autobus dhe ndihmonte të moshuarit.



- Një brez që ngjitej në një pemë dhe mblidhte fshehurazi pemë frutore që rriteshin edhe në shtëpitë e komshinjve.
- Një brez që kujdesej për ndjenjat, jo për paratë apo makinat.
- Një brez që kishte mësuar të përballojë në çdo kohë dhe në çdo rrethanë gjithçka me forcën e vet.
- Një brez që nuk mund të manipulohet kollaj në përditshmërinë e tij (jo politike).
- Një brez i mësuar të donte vendin e tij.
- Një brez që lexonte libra, pranë një llambe nën një batanije...

- Një brez që kaloi dhe për fat të keq nuk do të kthehet më!
- Një brez i varfër që nuk kishte asgjë, por kishte gjithçka!
- “Diskutimi i brezave”, kurrë nuk do të përfundojë, ndonëse do të vijë kohë edhe më të vështira që gjeneratat e ardhshme do ta shohin me skepticizëm fëmijërinë e prindërve të tyre, sepse çdo epokë ka karakteristikat e veta.

Prindërit dhe fëmijët u përkasin gjeneratave të ndryshme, dhe ata kanë psikologji të ndryshme. Midis tyre, nuk ka të mira dhe as të këqija, ato janë thjesht të ndryshme, dhe secila gjeneratë mbart të vërtetën e vet, kështu që kurrë nuk mund të ketë unitet dhe harmoni absolute midis tyre.

Nëse në fëmijërinë e hershme ky konflikt fillestar i qenësishëm i familjes manifestohet në formën e vargaresë dhe lotëve të fëmijërisë, atëherë ndërsa plaket bëhet më akute dhe dramatike. Në fillim, fëmija kërkon vëmendje, kujdes dhe dashuri, por sa më shumë rritet aq më shumë insiston për liri të plotë në të gjitha aspektet. Konfliktet ndërmjet brezave familjarë janë të paracaktuar dhe të pashmangshëm. E gjithë pyetja është, në çfarë forme shkojnë ato?

Në një familje harmonike, prindërit e ekuilibruar e të zgjuar janë në gjendje të ndërtojnë një marrëdhënie të vetme ekipore, ku të gjithë kanë vendin, rolin dhe qëllimin e tyre. Në këtë rast, pikëpamjet e ndryshme të fëmijëve dhe prindërve do të plotësojnë njëra-tjetrën, dhe do të punojnë për qëllime të përbashkëta: t’u japin të gjithëve mundësinë për të realizuar ëndrrën e tyre, për të zënë një vend në shoqëri, për t’u përmirësuar shpirtërisht. Ne thjesht duhet të përshtatemi, duke iu sjellë në përditshmërinë e tyre pak nga jeta jonë, jo thjesht nostalgji, por kohë e jetuar pa streset që brezat sot po mbajnë mbi supet e njomë..

KONFERENCA "NATO NË NJË UDHËKRYQ: PAMJE NGA SELIA E NATO-S DHE NORVEGJIA" NË OSLO

NATO nuk do të bëjë kurrë kompromis mbi parimet thelbësore që kanë siguruar sigurinë dhe prosperitetin

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană dhe Ministri norvegjez i Mbrojtjes Odd Roger Enoksen dhanë pikëpamjet e tyre mbi situatën në dhe rreth Ukrainës dhe përshtatjen e ardhshme të NATO-s.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm përsëriti se NATO nuk do të bëjë kurrë kompromis mbi parimet thelbësore që kanë siguruar sigurinë dhe prosperitetin tonë për më shumë se shtatëdhjetë vjet. Megjithatë, pavarësisht kësaj, ka shumë fusha ku ne mund të angazhohemi në dialog pozitiv me

Rusinë, duke përfshirë reduktimin e rrezikut, transparencën dhe kontrollin e armëve. Ai foli gjithashtu për zhvillimin e Konceptit të ardhshëm Strategjik të NATO-s, një dokument kyç që do të ndihmojë në drejtimin e Aleancës në vitet në vijim. Ai do të riafirmojë vlerat tona, qëllimin dhe detyrat tona dhe do të sigurojë një vlerësim kolektiv të mjedisit aktual të sigurisë. Konferenca "NATO në një udhëkryq: Pamje nga selia e NATO-s dhe Norvegjia" në Oslo, u organizua nga Komiteti Atlantik Norvegjez.



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s diskuton zhvillimet e ushtrisë ruse me Presidentin e Polonisë

Stoltenberg: Rusia ka vendosur mbi 100 000 trupa me aftësi të mundshme, duke përfshirë njësitë mjekësore, komandën, kontrollin dhe logjistikën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mirëpriti Presidentin Andrzej Duda të Polonisë në selinë e NATO-s, për bisedime rreth ngritjes së vazhdueshme ushtarake ruse në dhe rreth Ukrainës. Stoltenberg tha: "Rusia tani ka vendosur mbi 100,000 trupa me aftësi të mundshme, duke përfshirë njësitë mjekësore, komandën, kontrollin dhe logjistikën. Ne gjithashtu presim që rreth 30,000 trupa ruse të vendosen në Bjellorusi: grumbullimi më i madh atje që nga Lufta e Ftohtë. Këto dislokime nuk janë të justifikuara, janë jo transparente dhe shumë afër kufijve të NATO-s."

Sekretari i Përgjithshëm deklaroi se gatishmëria e Forcave të Reagimit të NATO-s tashmë është rritur dhe se NATO po shqyrton dislokimin e grupeve luftarake shtesë në pjesën juglindore të Aleancës. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti që Shtetet e Bashkuara po dërgojnë më shumë trupa në Poloni, Gjermani dhe Rumani, duke e quajtur këtë "një demonstrim të fuqishëm të përkushtimit amerikan ndaj Aleancës sonë". Aleatët e tjerë gjithashtu po kontribuojnë më shumë forca në NATO në tokë, në ajër dhe në det. Dislokimet tona janë mbrojtëse dhe proporcionale. Ato dërgojnë një mesazh të qartë: NATO do të bëjë gjithçka që është e nevojshme për t'u mbrojtur dhe për të mbrojtur të gjithë aleatët."

Stoltenberg theksoi se NATO mbetet e hapur ndaj dialogut për të gjetur një zgjidhje politike: "Sot, unë përsëris ftesën time drejtuar Rusisë për t'u takuar me aleatët e NATO-s në Këshillin NATO-Rusi. Ne jemi të gatshëm të dëgjojmë shqetësimet e tyre, të diskutojmë marrëdhëniet NATO-Rusi, reduktimin e rrezikut dhe transparencën, kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen, dhe çështje të tjera që ndikojnë në sigurinë tonë. Por NATO nuk do të bëjë kompromis mbi parimet thelbësore. Aftësia jonë për t'u mbrojtur dhe për të mbrojtur të gjithë aleatët, dhe e drejta e çdo kombi për të zgjedhur rrugën e vet."

Sot, projektet janë duke u zhvilluar në Ruandë, Senegal, Afrikën e Jugut dhe Gana. Javën e ardhshme, projekti i ri BioNTech në vendin e prodhimit në Marburg në Gjermani do të hapet dhe do të shohim që ky projekt pan-afrikan për prodhimin rajonal të vaksinave të fillojë.

Nisma jonë e ardhshme e Ekipit të Europës është një paketë mbështetëse shëndetësore. Ai do të trajtojë barrierat ndaj prodhimit në Afrikë nga të gjitha këndvështrimet, duke përfshirë aksesin në financa, transferimin e teknologjisë, kornizat rregullatore, zhvillimin e aftësive dhe njohuritë.

E di që mund të mbështetemi tek ju, për ta bërë këtë një përpjekje vërtet të përbashkët.

Samiti BE-Afrikë po afrohet me shpejtësi. Është një moment i rëndësishëm politik për sa i përket rezultateve të shëndetit publik që duam të ndjekim. Qëllimi ynë në Samit duhet të jetë largimi me plane konkrete për veprim dhe partneritet me Afrikën.

Sot ne jemi mbledhur këtu nga Presidenca Franceze për të biseduar mbi mënyrën se si mund të mbështesim më tej vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, jo vetëm për sa i përket vaksinave kundër COVID, por edhe për ndërtimin e një shtate shëndetësore të qëndrueshme, afatgjatë dhe sigurimin e aksesit universal në barnat thelbësore.

Faleminderit. Pres me padurim një diskutim të frytshëm, duke mos harruar kurrë se shëndeti global është me interes të përbashkët për të gjithë ne.



Zhvillimet e shpeshta në kufirin Kosovë-Serbi dhe provokimet nga ushtria serbe, i vlerësojmë kërcënim shumë serioz dhe duhet të adresohen fuqishëm politikisht nga Bashkimi European dhe me veprime e qëndrime konkrete nga NATO, respektivisht Komanda e Forcës së Bashkuar në Napoli (JFCNP) përmes operacionit KFOR në Kosovë.



Republika e Kosovës qëndron fuqishëm përkrah NATO-s në krizën mes Ukrainës dhe Rusisë

Ministria e Mbrojtjes përcjell me vëmendje maksimale zhvillimet e fundit dhe veprimet aktuale të Rusisë kundër Ukrainës, vendeve të krahut lindor të NATO-s, si dhe aktivitetet hibride që Rusia zhvillon në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Aktivitetet e luftës hibride, në rajonin tonë, Rusia përmes Serbisë, i realizon në vazhdimësi me luftën politike me metoda jokonvencionale destabilizuese të ndërthurura me aktivitete asimetrike siç janë sulmet kibernetike dhe ato përmes lajmeve të rreme (fake news).

Prandaj, kërkojmë vëmendje të shtuar të autoriteteve politike dhe ushtarake të NATO-s përmes Komandës së Forcës së Bashkuar në Napoli (JFCNP) në rajonin tonë, për të pamundësuar kështu ndikimin dhe influencën e qarqeve destabilizuese ruso-serbe të mbështetura edhe nga qarqet kineze në rajon.

Zhvillimet e shpeshta në kufirin Kosovë-Serbi dhe provokimet nga ushtria serbe, i vlerësojmë kërcënim shumë serioz dhe duhet të adresohen fuqishëm politikisht nga Bashkimi European dhe me veprime e qëndrime konkrete nga NATO, respektivisht Komanda



e Forcës së Bashkuar në Napoli (JFCNP) përmes operacionit KFOR në Kosovë.

Republika e Kosovës qëndron fuqishëm përkrah NATO-s të ud-

hëhequr nga SHBA, në interes të mbrojtjes së vlerave euroatlantike dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, kontinental dhe global.



Gjeneral Jashari, priti në takim ekipin e ekspertëve amerikanë të Institutit për Qeverisje të Sigurisë

Komandanti i FSK-së, gjeneralletenat Bashkim Jashari priti sot Ekspertët amerikanë të Institutit për Qeverisje të Sigurisë (Institute for Security Governance) të kryesuar nga z. Keith Dunn. Me këtë rast, Gjeneral Jashari shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për kontributin e ISG-së për mbështetjen në procesin zhvillimor dhe reformues të FSK-së. Ai gjithashtu shprehu falënderimin e thellë për SHBA-në për gjithë mbështetjen e pazëvendësueshme në të gjitha të arriturat e deritashme dhe vizionin tonë për të ardhmen. Nga ana e tij, z. Dunn uroi gjeneral Jasharin për detyrën e re duke shprehur besimin e plotë se procesi i tranzicionit të FSK-së do të vazhdojë të realizohet suksesshëm në përputhje me synimet e tij.

ISG ka mbështetur dhe vazhdon të mbështes leadershipin e Ministrinë së Mbrojtjes dhe FSK-në gjatë procesit përgatitor për tranzicion nga mandati i kaluar në mandatin ushtarak të saj.

Komandanti i FSK-së, gjeneralletenat Bashkim Jashari takim me oficeret e dalluara të FSK-së; u pritën edhe nga Presidentja Osmani

Komandanti i FSK-së, gjeneralletenat Bashkim Jashari priti në takim toger Liridona Baftjari - Jasharin, nëntoger Jeta Berishën dhe nëntoger Arbenita Haxholli - Grezdën, të cilat kanë treguar performancë të jashtëzakonshme gjatë kryerjes së kurseve të karrierës në akademitë e shteteve partnere.

Toger Liridona Baftjari - Jashari është oficer i fushës së komunikimit dhe ka përfunduar Kursin e Oficerit Shtabor në Institutin e Luftës Tokësore në Turqi. Për performancën e shkëlqyer gjatë këtij kursi Toger Baftjari u vlerësua si oficeri më i mirë ndërkombëtar.


Nëntoger Jeta Berisha është gjithashtu oficer i fushës së komunikimit dhe ka përfunduar Kursin Bazik të Oficerit për Sinjale në SHBA. Gjatë këtij kursi Nëntoger Berisha u dallua në përvetësimin e planit mësimor dhe u shpërblye me çmimin "Dexter Award", që jepet për oficerin e dalluar ndërkombëtar.

Nëntoger Arbenita Haxholli - Grezda është oficer i fushës së logjistikës dhe ka përfunduar Kursin Bazik të Oficerit për Logjistikë, në Universitetin Ushtarak për Logjistikë në SHBA. Nëntoger Haxholli - Grezda gjithashtu u diplomua në këtë kurs si studente e dalluar ndërkombëtare. Me këtë rast, Gjeneral Jashari, para oficerëve u shpreh se, ndihet krenar me arritjet



e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe falënderoi oficeret për përfaqësimin dinjitoz të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Po sot, Gjeneral Jashari së bashku me oficeret u pritën në takim nga Presidentja e Republikës së Kosovës, njëkohësisht Komandantja Supreme e FSK-së, znj. Vjosa Osmani, me këtë rast e njoftoi me arritjet e tyre.

Me këtë rast, Presidentja Osmani theksoi se arritjet e oficerëve tona janë pasqyra më e mirë e profesionalizmit dhe mundësive të barabarta në FSK. Kurse, Gjeneral Jashari shprehu bindjen e thellë që këto arritje do të inkurajojnë edhe më shumë gratë dhe vajzat e reja që të bashkohen në shërbim të atdheut.



“Integrimi i Maqedonisë së Veriut dhe Ballkanit Perëndimor në BE është një qëllim gjeostrategjik dhe një interes politik, i sigurisë dhe ekonomik si për rajonin ashtu edhe për Unionin. E vlerësojmë mbështetjen tuaj dhe jemi të gatshëm për fillimin e negociatave”, -tha ministrja Petrovska.



Ministrja Petrovska në takim me ambasadorin e BE-së Gir

Maqedonia e Veriut jep kontributin e saj të padyshtimtë për sigurinë europiane dhe rajonale, si dhe në politikën e përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë së Unionit. Pjesëtarët e Armatës janë pjesë e misionit të BE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, ALTHEA, si dhe misionit të Unionit në Republikën e Afrikës Qendrore. Vendi është pjesë e Europës, jeton me vlerat europiane dhe respekton parimet europiane, ndaj duhet të ndërmerret hapi tjetër: fillimi i negociatave për anëtarësim në BE. Hapja e negociatave është një sfidë që do të ndikojë pozitivisht në avancimin e proceseve në vend.

Këtë e deklaroi ministrja e Mbrojtjes, Sllavjanka Petrovska në takim me ambasadorin e BE-së, Dejvid Gir. “Integrimi i Maqedonisë së Veriut dhe Ballkanit Perëndimor në BE është një qëllim gjeostrategjik dhe një interes politik, i sigurisë dhe ekonomik si për rajonin ashtu edhe për Unionin. E vlerësojmë mbështetjen tuaj dhe jemi të gatshëm për fillimin e negociatave”, -tha ministrja Petrovska. Ministrja Petrovska dhe ambasadori i BE-së Gir u pajtuan se BE-ja dhe Maqedonia e Veriut e

“Do të punojmë së bashku për rezistencë ndaj kërcënimeve hibride”



njohin njëloj rëndësinë e çështjeve të rezistencës ndaj kërcënimeve hibride, infrastrukturës kritike dhe mbrojtjes civile dhe se do të thellojnë bashkëpunimin në këto fusha. Ambasadori i BE-së Gir mirëpriti planet e Minis-

trisë për të rritur Qendrën e NATO-s në Maqedoni, Qendrën Rajonale të Marrëdhënieve me Publikun, në një Qendër për Marrëdhëniet me Publikun dhe Menaxhimin e Dezinformimit.

Takim i ministres Petrovska me ambasadorin Bomgartner: Të përkushtuar për zhvillimin e bashkëpunimit në mbrojtje ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Francës

Maqedonia e Veriut dhe Franca kanë bashkëpunim të ngushtë dhe të frytshëm në mbrojtje dhe ky bashkëpunim ka perspektiva të reja dhe interesante në të ardhmen sepse të dyja vendet janë jashtëzakonisht të përkushtuara për të. Kështu deklaruan ministrja e Mbrojtjes Sllavjanka Petrovska dhe ambasadori i Francës, Cyril Bomgartner, në takim që u mbajt sot në Ministri.

Ministrja Petrovska foli edhe për politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të Unionit, duke theksuar se Maqedonia e Veriut kontribuon në këtë fushë. Duke pasur parasysh se Franca kryeson me Bashkimin Europian në gjysmën e parë të vitit, ministrja Petrovska ripohoi nevojën për fillim të shpejtë të negociatave për anëtarësim në

Petrovska takohet me ambasadorin spanjoll, Garsia: përkushtim për thellimin e bashkëpunimit në mbrojtje mes dy vendeve

Ministrja Sllavjanka Petrovska sot në Ministrinë e Mbrojtjes u takua me ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës në vendin tonë, Hose Luis Lozano Garsia. Në takim, ministrja Petrovska dhe ambasadori Garsia konfirmuan marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale të mbrojtjes ndërmjet dy vendeve dhe theksuan se ka hapësirë dhe gatishmëri nga të dyja palët për thellimin dhe intensifikimin e këtij bashkëpunimi. Në kuadër të NATO-s, ministrja tha se vendi mbetet i përkushtuar ndaj aleancës dhe se pret me padurim Samitin e ardhshëm të Lidershit të NATO-s që do të mbahet në Madrid këtë vit. Ambasadori Garsia shprehu kënaqësinë që Spanja kontribuoi në procesin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, duke ratifikuar anëtarësimin e saj përkundër sfidave me të cilat u

përball në fillim të pandemisë, si dhe përgëzoi vendin për shpejtësinë e integrimit ushtarak në NATO, duke qenë se Maqedonia e Veriut përfundoi këtë proces kompleks në një kohë rekord, pra në vetëm 19 muaj.

Të dy vendet e bazojnë bashkëpunimin e tyre në



Memorandumin e Bashkëpunimit të vitit 2009, sipas të cilit oficerë të Armatës kanë ndjekur trajnim gjuhësor dhe një oficer u dërgua në një trajnim të lartë ushtarak në Kolejin Ushtarak në Madrid.



Union. “Maqedonia e Veriut ka bërë përparim jashtëzakonisht të madh dhe Unioni duhet të ndërmarrë hapin tjetër që do të jetë një motivim i fortë për zhvillim edhe më të madh. Vendi respekton dhe mbështet politikën europiane dhe vendit tonë i takon të jetë në Bashkimin Europian. Ne kemi bërë shumë në vitet e fundit, reformat janë të dukshme dhe për këtë meritojmë të fillojmë procesin e anëtarësimit”, -tha ministrja Petrovska. Ambasadori Bomgartner tha se Franca e mbështet plotësisht Maqedoninë e Veriut në rrugën e saj drejt Unionit dhe tha se negociatat për anëtarësim duhet të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Bashkëpunimi mes dy vendeve dhe dy ushtrive mund të shihet përmes trajnimeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjes së përbashkët në stërvitjet ushtarake. Ushtarët francezë do të marrin pjesë edhe në stërvitjen e ardhshme më të madhe ushtarake të organizuar ndonjëherë në vendin tonë, “Swift Response 22”. Maqedonia e Veriut dhe Franca bashkëpunojnë në mënyrë aktive në fushën e trajnimit gjuhësor dhe edukimit të pjesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në shkollat më të larta ushtarake në Francë.

Marrëveshja e Gjelbër Europiane

Ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor janë një kërcënim ekzistencial për Bashkimin European dhe për botën. Për t'i tejkaluar këto sfida, Marrëveshja e Gjelbër Europiane është strategjia e re e rritjes për Europën, e cila do ta shndërrojë Bashkimin European në një ekonomi me burime efçente dhe konkurruese.

Marrëveshja e Gjelbër Europiane ka synim ta bëjë klimën europiane neutrale deri në vitin 2050, të forcojë ekonominë nëpërmjet teknologjisë së gjelbër, të krijojë një ekonomi dhe transport të qëndrueshëm dhe të reduktojë ndotjen. Duke kthyer sfidat e klimës dhe mjedisit në mundësi, do ta bëjë tranzicionin të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë.

Komisioni European ndihmon shtetet anëtare të projektojnë dhe të zbatojnë reforma që mbështetin tranzicionin e gjelbër dhe kontribuojnë në arritjen e synimeve të Marrëveshjes së Gjelbër Europiane. Gjithashtu ndihmon në krijimin e procedurave të nevojshme në administratën lokale dhe qendrore dhe vendosjen e strukturave të koordinimit që nevojiten për implementimin e politikave të gjelbra.

Veprimi ndaj klimës dhe reduktimi i emetimeve

Veprimi ndaj klimës është në zemër të Marrëveshjes së Gjelbër Europiane. BE-ja tashmë ka një histori të fortë në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë duke ruajtur rritjen ekonomike. Edhe më shumë duhet bërë në vitet e ardhshme. BE-ja vendosi objektivat e saj për të arritur neutralitetin ndaj klimës deri në vitin 2050, prandaj kjo do të kërkojë që të gjitha Shtetet Anëtare të zbatojnë një grup koherent politikash klimatike.

Komisioni European, nëpërmjet Instrumentit të Mbështetjes Teknike, ndihmon autoritetet kombëtare të hartojnë dhe zbatojnë reforma që mbështesin ambiciet e tyre klimatike.

Shembuj mbështetje

- Zhvillimi i politikave klimatike duke përfshirë këshilla për strategjitë dhe planet e veprimit për klimën, dhe mbështetjen për modelimin e emetimeve të gazeve serrë.
- Mbështetja e përdorimit të tokës dhe menaxhimit e pyjeve, duke përfshirë planifikimin urban, qytetet SMART dhe kontabilitetin dhe inventarin e pyjeve.
- Rritja e mbrojtjes së brigjeve si dhe menaxhimi i përmbytjeve dhe rrezikut të erozionit bregdetar
- Zhvillimi i zgjidhjeve me bazë natyrale për të adresuar valët e të nxehtit, përmbytjet dhe cilësinë e dobët të ajrit në zonat urbane.
- Zbatimi i instrumenteve të financimit në kuadër të sistemit tregtimit të emetimeve të BE-së.
- Mbështetja e dekarbonizimit të sistemeve të elektricitetit, duke përfshirë hartimin e tregjeve dashamirës ndaj energjisë së rinovueshme dhe kornizave rregullatore.
- Zhvillimi i skemave mbështetëse të bazuara në treg për energjinë e rinovueshme dhe investimet në efçencën e energjisë.
- Zhvillimi i planeve kombëtare të energjisë dhe klimës, duke përfshirë modelimin analitik dhe të energjisë.
- Vlerësimi i politikave për sistemet



e ngrohjes dhe ftohjes me efikasitet energjetik.

- Rritja e investimeve për efçencën e energjisë në ndërtesa.
- Përcaktimi i politikave për transport/lëvizshmëri të qëndrueshme dhe lëndë djegëse alternative.
- Përforsimi i transportit ujor të brendshëm dhe hekurudhave me shpejtësi të lartë.

Vetëm tranzicion

Të gjitha shtetet anëtare të BE-së, rajonet dhe sektorët duhet të kontribuojnë në tranzicionin drejt një ekonomie neutrale ndaj klimës. Megjithatë, shkalla e sfidës nuk është e njëjtë për të gjithë. Rajonet e varura nga lëndët djegëse fosile dhe industritë me intensitet karboni do të preken veçanërisht dhe do t'i nënshtrohen një transformimi të thellë ekonomik, mjedisor dhe social.

Komisioni European po ndihmon Shtetet Anëtare të mobilizojnë burimet dhe të ndërmarrin veprime për të siguruar mbështetje të synuar për rajonet dhe sektorët që janë më të prekur nga ky tranzicion. Nëpërmjet Instrumentit të Mbështetjes Teknike, DG REFORM po mbështet gjithashtu 17 shtete anëtare në përgatitjen e planeve të tyre të tranzicionit të drejtë territorial, të cilat çdo Shtet Anëtar do të duhet të hartojë për të marrë akses në financim nga Mekanizmi i Tranzicionit të Drejtë.

Shembuj mbështetje

- Vlerësimi i sfidave dhe nevojave të tranzicionit.
- Përgatitja e një plani veprimi me një udhërrëfyes të masave të nevojshme për kalimin në një ekonomi neutrale ndaj klimës.
- Mbështetja e konsultimeve me palët e interesuara për të krijuar një konsensus se si të kalojmë në një ekonomi neutrale ndaj klimës.
- Propozimi i mekanizmave qeverisës për zbatimin e tranzicionit.

Zhvillimi i qëndrueshëm

BE-ja është plotësisht e përkushtuar për të qenë një kryesues në zbatimin e Axsendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, së bashku me shtetet e saj anëtare. 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG) kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së njerëzve dhe mbrojtjen e planetit nga degradimi, në mënyrë që të mund të mbështesë nevojat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.

Që nga viti 2020, Komisioni European ka përforsuar analizën dhe monitorimin e tij të arritjes së SDG-ve në procesin e Semestrit European. Paralelisht, Shtetet Anëtare janë duke integruar SDG-të në politikëbërjen e tyre dhe po zhvillojnë politika të synuara për të ecur drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm.

Shembuj mbështetje

- Zhvillimi i një strategjie të zhvillimit të qëndrueshëm për vitin 2050.
- Zhvillimi i një plani veprimi për të përmirësuar mirëqenien e banorëve ruralë dhe për të siguruar stabilitetin ekonomik të zonave rurale.
- Zbatimi i strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm duke përfshirë SDG-të në vendimmarrje në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Energjia

Dekarbonizimi i sistemit energjetik është thelbësor për të arritur objektivat klimatike të BE-së në 2030 dhe 2050. Në të njëjtën kohë, energjia duhet të jetë e sigurt dhe e përbalueshme për konsumatorët dhe bizneset. Që kjo të ndodhë, shtetet anëtare duhet të transformojnë sistemet e tyre të energjisë në një treg energjie plotësisht të integruar, të dixhitalizuar dhe konkurrues të BE-së, i cili bazohet kryesisht në burimet e rinovueshme. Përveç reformave rregullatore, Shtetet Anëtare duhet të mundësojnë dhe promovojnë investime të mëtejshme në energjinë e pastër, duke përfshirë efçencën e energjisë.

Shembuj mbështetje

- Përshtatja e kuadrit legjislativ dhe rregullator për rritjen e pjesëve të energjisë së rinovueshme.
- Përcaktimi i masave të politikave për të promovuar efçencën e energjisë.
- Hartimi i tregjeve konkurruese të energjisë elektrike.
- Heqja e barrierave në tregjet e financimit dhe shërbimeve për energjinë e pastër.
- Mbështetja e planifikimit strategjik përmes modelimit dhe analizës së energjisë.

Transporti dhe lëvizshmëria

Transporti lejon njerëzit, shërbimet dhe mallrat të lëvizin lirshëm brenda Bashkimit European. Ai është një gur themeli i integritetit në BE, që

lidh njerëzit në rajone dhe vende të ndryshme dhe një kontribuues i madh në ekonomi. Kërkesa për transport vazhdon të rritet ndërsa ekonomitë bëhen më të integruara. Kjo sjell mundësi por edhe sfida të reja. Në veçanti, transporti përfaqëson pothuajse një të katërtën e emetimeve të gazeve serrë të BE-së dhe është një nga shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit në qytete. Shtetet anëtare po kërkojnë mënyra për të zhvilluar zgjidhje të zgjuara, të qëndrueshme dhe efikase të transportit. Kjo kërkon vendosjen e përdoruesve në radhë të parë dhe ofrimin e alternativave më të përbalueshme, më të aksesueshme, më të shëndetshme dhe më të pastra.

Shembuj mbështetje

- Duke analizuar politikat, instrumentet ekonomike dhe kornizat ligjore.
- Kryerja e analizave kosto-përfitim.
- Zhvillimi i modelimit mbi skenarët dhe ndikimet e investimeve.
- Zhvillimi i rekomandimeve të politikave, planeve të veprimit dhe hartave rrugore.
- Hartimi i strategjive dhe planeve të komunikimit.

Mjedisi dhe ekonomia rrethore

Degradimi i mjedisit pritet të ndikojë gjithnjë e më shumë në aktivitetin ekonomik. Mund të shkaktojë kushte ekstreme të motit, të ketë ndikim në shëndetin e njeriut dhe t'i bëjë burimet natyrore më pak të aksesueshme. Mbrojtja e kapitalit natyror të BE-së, kalimi në një ekonomi me burime efikase dhe mbrojtja e njerëzve nga presionet e lidhura me mjedisin janë prioritetet kryesore të Marrëveshjes së Gjelbër Europiane. Shtetet Anëtare po angazhohen në reforma për të adresuar këto sfida duke zhvilluar më tej politikat dhe strategjitë e tyre mjedisore.

DG REFORM/The Directorate-General for Structural Reform Support (Drejtoria e Përgjithshme për Mbështetjen e Reformës Strukturore) mbështet autoritetet kombëtare në hartimin dhe zbatimin e reformave që ndihmojnë në adresimin e degradimit të mjedisit.

Shembuj mbështetje

- Përcaktimi i politikave kombëtare dhe komunale të menaxhimit të mbetjeve.

- Përgatitja e strategjive kombëtare të ekonomisë rrethore dhe planeve të veprimit.
- Instrumentet zbatuese për dekarbonizimin e industrive.
- Mbështetja e menaxhimit të ujit dhe monitorimit të shërbimeve të ujit.

Hulumtimi dhe inovacioni

Teknologjitë dixhitale kanë një ndikim të thellë në mënyrën tonë të jetesës dhe të bërit biznes. Shtetet anëtare duhet të kenë kapacitetin për të përfutur nga shoqëria jonë gjithnjë e më e dixhitalizuar dhe për të përballuar sfidat që ajo sjell. Kjo kërkon hartimin e politikave dhe vendosjen e zgjidhjeve inovative për t'i dhënë bizneseve besimin, kompetencat dhe mjetet për t'u dixhitalizuar dhe rritur. Një strategji kërkimore dhe inovative sistematike dhe largpamëse është thelbësore për një ekonomi më produktive dhe të gjelbër.

Shembuj mbështetje

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet biznesit dhe shkencës për të përmirësuar zbatimin e politikave të inovacionit.
- Adresimi i mungesës së kapaciteteve në institutet kërkimore, veçanërisht përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira.
- Rritja e performancës inovative të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

“Gjelbërimi” i financave publike dhe private

Për të arritur ambicien e Marrëveshjes së Gjelbër Europiane, nevojiten investime të konsiderueshme. Sektori privat do të luajë një rol kyç në financimin e tranzicionit të gjelbër. Kjo kërkon strategji të qëndrueshme, korniza rregullatore novatore dhe instrumente inteligjente. Qeveritë kombëtare do të jenë gjithashtu instrumentale në financimin e tranzicionit, duke dërguar sinjalet e duhura të çmimeve dhe duke riorientuar shpenzimet publike drejt politikave të qëndrueshme. Ata gjithashtu duhet të stimulojnë kërkesën për mallra dhe shërbime më të qëndrueshme përmes prokurimit publik të gjelbër dhe të zvogëlojnë gjurmën e karbonit të shërbimeve publike. Një kornizë solide e qeverisjes do të sigurojë që vendimmarrësit të jenë të përgjegjshëm ndaj brezave të ardhshëm. Për të adresuar këto sfida, DG REFORM po mbështet Shtetet Anëtare në fushat: buxhetimi i gjelbër dhe tatimet mjedisore; prokurimi i gjelbër; financa dhe investime të qëndrueshme.

Shembuj mbështetje

- Forcimi i investimeve publike të gjelbra.
- Zbatimi i rishikimeve të shpenzimeve dhe shpenzimeve tatimore të politikave të gjelbra dhe jo miqësore ndaj mjedisit (“gri”) në kornizat buxhetore.
- Projektimi i taksimit të gjelbër dhe modelimi i ndikimit të tij.
- Zbatimi i udhëzimeve të BE-së për buxhetimin e gjelbër.
- Zhvillimi i një plani veprimi financiar të qëndrueshëm për Shtetet Anëtare dhe institucionet kombëtare promovuese.
- Zbatimi i kornizave të obligacioneve të gjelbra sovraane.

Koncepti ushtarak për termin “luftë civile”



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Ushtarakët shprehen për

koncepte profesionale ushtarake
Libri “Përtej shtrembërimeve”

ka për autorë dy ushtarakë të lartë të Forcave të Armatosura Zeno Jahaj dhe Agron Berdaj. Është një libër i thjeshtë dhe pa bujë mediatike, por që afron shumë koncepte dhe terma profesionale ushtarake, të cilat argumentojnë dhe shterojnë morinë e fjalëve dhe të historianëve për konceptin e luftës civile. Në vitet e fundit në Shqipëri, shumë libra, shkrime apo deklarata politike, kanë bërë përpjekje për të interpretuar luftën për çlirimin e Shqipërisë nga nazifashizmi si “luftë civile”.

Duke shqyrtuar mbi bazën e kritereve, të hulumtuara të pranura nga studiues e organizma ndërkombëtare të paanshëm, se çfarë është me përcaktim termi “luftë civile”. Autorët qartësojnë kushtet dhe kriteret, sipas të cilave një luftë mund të cilësohet e tillë, luftë civile. Ata kanë argumentuar mbi bazën e kritereve, duke ballafaquar në mënyrë të paanshme zhvillimet dhe realitetet në terrenin konkret të Shqipërisë në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Sipas fjalorit, termi luftë civile është një konflikt i armatosur, ku palët e organizuara të së njëjtës shoqëri dhe kombësi brenda një shteti, luftojnë kundër njëra-tjetrës për të marrë nën kontroll pushtetin politik në qendër, ose në një rajon të vendit. Termi “luftë civile” në shtetin ku zhvillohet, ka vetëm palë “të së njëjtës shoqëri e kombësi brenda një shteti” dhe se këto palë “luftojnë kundër njëra-tjetrës për të marrë nën kontroll pushtetin politik”. Pra shteti i përfshirë në luftë civile nuk mund të jetë nën pushtimin e një shteti tjetër. Pushtuesi, dihet që nuk është i “të njëjtës shoqëri e kombësi brenda një shteti”, por, ai ka vendosur pushtetin politik mbi shtetin e pushtuar. Kështu palët e “të njëjtës shoqëri e kombësi brenda një shteti” nuk mund të synojnë pushtetin politik, pasi shteti i tyre gjendet nën pushtim të huaj.

Teza për luftë civile

në Shqipëri nuk qëndron, pse?

Autorët theksojnë dhe argumentojnë qartë se në kushtet kur lufta e zhvilluar në Shqipëri gjatë pushtimit nazifashist ishte luftë civile, nuk qëndron. Atributet politike të administrimit të shtetit në luftë kryeshin nga pushtuesit, në ortakëri me qeveritë kukulla shqiptare të emëruara prej tyre, jo të zgjedhura nga populli.

E shpërfillim rrethanën e kriter të parë dhe të pranojmë që u zhvillua luftë civile, pavarësisht se Shqipëria ishte e pushtuar. Mirëpo duhet të sqarojmë se cilat ishin palët e përfshira në atë luftë. Duhet se në çdo luftë në përlëshje ka të paktën dy palë. Ata që theksojnë se lufta e zhvilluar në Shqipëri gjatë pushtimit nazifashist ishte luftë civile, cilësojnë njërin palë, Ushtrinë partizane të udhëhequr nga Partia Komuniste. Por, në përcaktimin klasik të luftës civile, duhet



të cilësohet se cila ishte pala tjetër. Në atë kohë, pala tjetër ishte Organizata “Balli Kombëtar” dhe Organizata “Lëvizja e Legalitetit”.

Palët në “luftën civile” në Shqipëri, kanë qenë Ushtria Nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Partia Komuniste njëra palë dhe Organizata e “Ballit Kombëtar”, e vetme, pala tjetër ose pala e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e udhëhequr nga Partia Komuniste dhe pala e Organizatës “Balli Kombëtar”, bashkë me Organizatën Kombëtare “Lëvizja e Legalitetit”.

Kështu, lufta e zhvilluar në Shqipëri gjatë pushtimit nazifashist ishte luftë civile, atëherë sipas këtij kriteri të dytë, theksojnë autorët, bashkëpërgjegjës për këtë shkarje nga detyrimi kombëtar antifashist e antinazist në vëllavrasje, janë, në të njëjtën masë, si pala e Ushtrisë Nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Partia Komuniste, edhe pala e Organizatës “Balli Kombëtar”, e vetme, apo bashkë me Organizatën “Lëvizja e Legalitetit”.

Kriteri territorial

apo lufta politike, pse?

Të dhënat, informacionet, dokumentet dhe zhvillimet konkrete në terren, në luftë, plotësohen me kriterin territorial. Lufta civile, si konflikt i armatosur, kryhet për të marrë nën kontroll pushtetin politik në qendër, ose në një rajon, pra, në një territor të përcaktuar. Lufta krijon vija fronti midis palëve. Nëse lufta e zhvilluar në Shqipëri gjatë pushtimit nazifashist ishte luftë civile, atëherë “mbrojtësit” e kësaj teze duhet të plotësojnë hartën

përkatesë. Në këtë hartë duhet të jenë rajonet apo territoret e kontrolluara nga njëra palë, rajonet dhe territoret e kontrolluara nga pala tjetër, si dhe vijat e frontit që i ndajnë forcat luftuese. Kështu zhvillimet konkrete në terren, në luftë nuk e analizojnë fare këtë kriter...

Në skenë del kriteri numër katër, që është politik, ku shfaqet forca njerëzore dhe armët. Kjo luftë zhvillohet në formën e shumë operacioneve, betejave dhe luftimeve. Betejat dhe luftimet e fillojnë, e mbajnë gjallë dhe e përfundojnë luftën. Duke qenë se në përmbajtje lufta civile është “luftë”, atëherë, edhe lufta e zhvilluar në Shqipëri gjatë pushtimit nazifashist, normalisht duhej të zhvillohej përmes operacionesh, betejash dhe luftimesh midis palëve, ku njëra palë do ishte fituese dhe pala tjetër, humbëse. Zhvillimet konkrete në terren, në luftë nuk e mbështesin as këtë kriter të katërt. Pra, nuk janë zhvilluar operacione, beteja dhe luftime, ku palë e vetme të ishin njësi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare nga njëra anë dhe njësi të Organizatës “Balli Kombëtar” apo Organizatës “Lëvizja e Legalitetit” nga ana tjetër.

Nuk flitet për “luftë civile” në këto raste...

Po ku mbështeten “argumentuesit” sipas të cilëve lufta e zhvilluar në Shqipëri gjatë pushtimit nazifashist ishte luftë civile. Sipas statistikave për humbje jetë njerëzish nga të dy palët, përgjatë veprimeve luftarake e jo luftarake, të zhvilluara më 16 tetor 1943, në Libofshë mbetën të vrarë 21 partizanë dhe 10 ballistë. Nga numrin

i të vrarëve, del se ka vetëm shqiptarë në luftim me njëri-tjetrin. Por kuadri i vërtetë i luftimeve në bazë të informacioneve dhe dokumenteve arkivore, të huaja dhe shqiptare, rezulton se komanda gjermane, po përforconte bregdetin shqiptar nga zbarkimi i mundshëm anglo-amerikan, prandaj për të siguruar pushtetin dhe rendin në qendrat e mëdha afër bregdetit, siç ishte dhe Libofsha. Në luftime, forcat gjermane u mbështetën nga forcat balliste të zonës. Këto luftime nuk ishin “luftë civile” dhe palët nuk ishin thjesht shqiptare. Përkundrazi, njëra palë ishte e huaj pushtuese e mbështetur nga forca shqiptare (ballistët) dhe pala tjetër kundër saj ishte një forcë shqiptare (forcat partizane).

Në Luftën e Dukatit, të zhvilluar më 30 nëntor 1943, midis forcave partizane dhe balliste, mbetën të vrarë 14 partizanë dhe 10 ballistë. Duket sikur kanë qenë vetëm këto forca, por realiteti ishte se komanda gjermane, po përforconte bregdetin shqiptar nga ndonjë zbarkim anglo-amerikan dhe mori masa për sigurinë e rrugës paralele me bregdetin. Gjermanët kishin angazhuar forcat e një regjimenti dhe rreth 300 ballistë. Luftimet në Dukat më 30 nëntor 1943 u zhvilluan në kuadrin e përbashkët të operacionit të forcave të palës gjermane të mbështetura nga forcat balliste të zonës, kundër forcave partizane. Këto luftime nuk ishin “luftë civile”, pasi palët nuk ishin vetëm shqiptarë, por dhe pushtues të mbështetur dhe të lidhur taktikisht me forcat balliste kundër forcave partizane.

Në Fushë-Alie, më 9 korrik 1944, partizanët u përbashkët me forcat e Halil

Alisë dhe mbetën të vrarë 21 partizanë. Në kuadrin e operacionit gjerman “Syri i Skifterit” për të penguar kalimin e Divizionit I Sulmues në Veri të Shqipërisë, në drejtimin Peshkopi-Shëngjergj-Kukës, u angazhuan dhe forca të bajraktarëve vendas, midis të cilëve dhe forca të Halil Alisë, duke bllokuar rrugëkalimet në bajrakët e tyre, plotësuan qëllimet e operacionit gjerman. Edhe ky rast tregon që nuk ishin vetëm dhe thjesht shqiptarë, por dhe pushtues të bashkërenduar me forca shqiptare, çeta e Halil Alisë, kundër forcave partizane.

Rreshtimi i Ballit Kombëtar në mbështetje, bashkëpunim e bashkërendim me forcat gjermane e kanë theksuar dhe shërbimet britanike të informacionit, të cilat raportnin se anëtarët e Ballit Kombëtar luftojnë përkrah gjermanëve dhe kundër partizanëve...

Mirëpo historishkruesit të prirur për të paraqitur si “luftë civile” çfarëdo vrasje shqiptarë me shqiptarë, iu referohen akteve të datës 13 tetor 1943, ku forca partizane masakruan 2 anëtarë të BK, në Melçem të Korçës, më 21 tetor 1943, ku forcat partizane kapën rob dhe ekzekutuan 68 ushtarë të BK në Lushnjë, më 29 tetor 1943, ku komunistët vranë në Kavajë 2 anëtarë të BK, më 21 gusht 1944, ku forcat antikomuniste vranë 5 partizanë në Vig, më 25 shtator 1944, në Lumë të Kukësit u vranë mbi 20 partizanë etj.

Akte të tilla nuk përmbushin asnjë kriter për t’u quajtur si “luftë civile”. E vërtetë se këto akte janë kryer “midis shqiptarëve”, por këto nuk kanë qenë operacione, beteja dhe luftime të zhvilluara nga njësi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare nga njëra anë me njësi të Organizatës “Balli Kombëtar” nga ana tjetër. Për më tepër, numri i përgjithshëm i të vrarëve në këto akte masakrimi, për të dyja palët së bashku, shkon rreth 100 luftëtarë, tregues i cili nuk mund të paraqitet si luftë civile.

Kur Shqipëria u vu nën pushtimin dhe administrimin e vetëm gjerman, BK u rreshtua në krah të forcave gjermane. Në këto kushte, teza se “lufta e zhvilluar në Shqipëri gjatë pushtimit nazifashist ishte luftë civile” rrëzohet vetvetiu edhe për kohën e pushtimit italian. Bashkëpunimi ishte mishëruar në plane konkrete të përbashkëta midis komandave gjermane dhe udhëheqës të Ballit Kombëtar. Sipas planeve, me qëllim kryerjen e operacioneve të spastrimit të forcave partizane, ballistët u angazhuan në detyra zbulimi dhe raportimi në komandën gjermane për numrin e forcave nacionalçlirimtare, vendndodhjen, armatimin dhe planet e luftimit të tyre, në detyra shoqërimi për trupat gjermane, jo vetëm si udhërrëfyes, por dhe për të kryer luftime në krah të tyre, në detyra informacioni për të siguruar të dhëna për forcat partizane etj. Libri ka shumë koncepte profesionale ushtarake dhe shquhet për një qartësi të tyre, ato koncepte ushtarake duhet të njihen mirë edhe nga politikanë, por dhe nga studiues e historianë që e kanë bërë një lëmsh të madh e të ngatërruar në ngjarjet ushtarake të zhvilluar gjatë LANÇ-it, për mungesë të formimit ushtarak të tyre.



FORCAT SPECIALE

"Selita 02", testim i kapaciteteve
larg venddislokimit të përhershëm

